



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SENATI AKADEMIK

Nr. 399 Prot.

Vlorë, më 18.02.2020

VENDIM

Nr. 64, datë 18.02.2020

PËR

ÇELJEN E PROCEDURAVE PËR NGRITJEN E KOMISIONIT TË APELIMIT NË UV


Në zbatim të Urdhrit Ministres së MASR, znj. Besa Shahini, Nr. 8, datë 14. 01. 2020 "Për procesin zgjedhor për autoritetet dhe organet drejtuese në IAL", të Urdhrit të Rektorit të Universitetit, Nr. 9, datë 03. 02. 2020 "Për fillimin e procesit zgjedhor për autoritetet dhe organet drejtuese në Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë, nenit 39 të Rregullores "Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë, Senati Akademik në mbledhjen e datës 18.02.2020


VENDOSI:

1. Të miratojë çeljen e procedurave për ngritjen e Komisionit të Apelimit në UV.
2. Të miratojë çeljen e procedurës për vetëkandidim për anëtarë të Komisionit të Apelimit në UV si dhe njoftimin zyrtar me kriteret përkatëse, drejtuar personelit akademik dhe studentëve, në funksion të regjistrimit për vetëkandidim, bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Të miratojë përbërjen e Komisionit të Apelimit, nga 5 (pesë) anëtarë, personel akademik, të paktën nga një për çdo fakultet. Në rast se nuk ka kandidatë të paraqitur nga një fakultet, atëherë vijon lista më poshtë.
4. Të miratojë e afatin kohor të pranimit të vetëkandidimeve i cili zgjat 5 (pesë) ditë pune duke filluar nga data e nënshkrimit dhe shpalljes nga Kryetari i SA të këtij vendimi.
5. Vetëkandidimet dorëzohen në sekretarinë (Zyrës së Arkivit Qendror të UV) e UV dhe administrohen nga sekretaria e SA.
6. Vendimi shpallet në *Webi*-n e UV dhe i dërgohet personelit akademik, drejtuesve të njësive bazë dhe kryesore për njohje dhe zbatim.
7. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. Roland ZISI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SENATI AKADEMIK

Nr. _____ Prot.

Vlorë, më ____ .02.2020

Lënda : Njoftim për vetëkandidim për anëtarë të Komisionit të Apelimit

NJËSIVE KRYESORE, NJËSIVE BAZË DHE PERSONELIT AKADEMIK

Në zbatim të nenit 39 të Rregullores "Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë, Urdhërit të Rektorit Nr. 9, datë 03.02.2020 "Për fillimin e procesit zgjedhor për autoritetet dhe organet drejtuese në Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë si dhe Vendimit të SA nr.64, date 18.02.2020, njoftohen anëtarët e stafit akademik të njësive kryesore të cilët janë të interesuar për të vetëkandiduar si anëtarë të Komisionit të Apelimit, se nga data 18.02.2020 deri më 24.02.2020, ora 16.00, duhet të paraqesin kerkesën për vetëkandidim pranë sekretarisë (Zyrës së Arkivit Qendror të UV) së UV.

Kriteret për anëtarët të Komisionit të Apelimit:

- Kanë përvojë pune në mësimdhënie, jo me pak se 5 (pesë) vjet, me kohë të plotë;
- Nuk kanë qenë asnjëherë të dënuar për vepra penale me vendim të formës së prerë;
- Nuk kanë lidhje gjinore në vijë të drejtë ose të tërthortë deri në shkallë të katërt, me kandidatë që konkurojnë në zgjedhje. Në rast konstatimi të tillë, anëtari dorëhiqet menjëherë dhe zëvendësohet nga Senati Akademik me short.

Anëtari i Komisionit të Apelimit nuk ka të drejtë të kandidojë për autoritet drejtues ose në organet drejtuese, të çdo niveli.

KRYETARI SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. Roland ZISI

